



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më.30 janar 2012
Nr. ref.: RK196/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 19/09

Parashtrues

Mehmet Llapashtica

kundër

Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. 120/2008, të 1 janarit 2009

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Mehmet Llapashtica, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. 120/2008, i 1 janarit 2009.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi e dorëzoi një kërkesë në Sekretariatën e Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), në të cilën pohonte që Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KEK) ia kishte shkelur të drejtën e tij të punës, të garantuar me Kushtetutë, veçanërisht me nenin 49.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), neni 22.7 dhe 22.8 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Sekretariatën e Gjykatës më 19 shtator 2009.
6. Kryetari e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Gjyljeta Mushkolaj. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për këtë kërkesë.
7. Në përgjigje ndaj njoftimit për kërkesë që i ishte dërguar KEK-ut, Zyra Ligjore e KEK-ut iu përgjigj Gjykatës Kushtetuese dhe dërgoi, ndër të tjera, ankesën disiplinore dhe procesverbalin e një shqyrtimi verbal të mbajtur nga KEK-u për këtë çështje më 28 prill 2004.
8. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues më 16 qershor 2010, dhe i rekomandoi Gjykatës se kërkesa ishte e papranueshme.

Përmbledhje e fakteve

9. Parashtruesi ishte i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) si elektromontues në Prishtinë. KEK-u ndërmori masa disiplinore kundër tij për shkak se ai kishte marrë pa leje një transformator elektrik, që ishte pronë e KEK-ut. Gjatë një shqyrtimi verbal, parashtruesi mohoi ta kishte marrë transformatorin pa leje, por pranoi se, me të tjerët, ai kishte marrë 800 euro për punën e kryer privatisht jashtë orarit të punës.
10. Më 28 prill 2004, komisioni disiplinor i KEK-u konstatoi që parashtruesi i kishte shkelur detyrat e punës dhe ia shkëputi kontratën e punës.
11. Parashtruesi parashtrroi ankesë kundër këtij vendimi në komisionin disiplinor të shkallës së dytë. Ai pohoi se nuk e kishte transferuar transformatorin sipas kërkesës së të tjerëve, por kishte leje nga shefi i distriktit të KEK-ut. Komisioni disiplinor i shkallës së dytë e refuzoi ankesën e tij me vendimin e 2 qershorit 2006.
12. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër largimit të tij nga puna, e cila e mbështeti padinë e tij dhe Gjykata, në Aktgjykimin e vet Cl. Br. 167/2006,

të 28 shtatorit 2006, urdhëroi që parashtruesi të kthehej në punë. KEK-u ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e cila, përmes Aktgjykimit të vet AC. nr. 1016/2006, të 31 korrikut 2007, e hodhi poshtë ankesën e KEK-ut dhe e miratoi vendimin e gjykatës komunale.

13. KEK-u u ankua kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila, përmes Aktgjykimit të vet Rev. nr. 120/2008, të 1 janarit 2009, e miratoi ankesën e KEK-ut dhe e anuloi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, duke mbështetur me këtë rast largimin e parashtruesit nga punësimi me KEK-un. Gjykata Supreme konstatoi që Gjykata Komunale gabimisht e kishte zbatuar të drejtën materiale kur kishte konstatuar që padia e parashtruesit ishte e bazuar.
14. Gjykata Supreme theksoi se Ligji themelor i punës në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/27, që hyri në fuqi më 8 dhjetor 2001, parashikonte shkëputjen e kontratës së punës. Gjykata vuri në pah se Ligji parashikonte shkëputjen e kontratës së punës në raste të sjelljes së keqe, duke përfshirë vjedhjen, shkatërrimin e pronës, dëmtimin ose shfrytëzimin e paautorizuar të pasurisë së punëdhënësit. Për këto arsye, Gjykata Supreme konstatoi që ankesa e KEK-ut ishte e bazuar dhe i anuloi aktgjykimet e Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës së Qarkut dhe e hodhi poshtë padinë e parashtruesit.

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi pohon, pa shtjellim të mëtejshëm, se i është shkelur e drejta e tij për punë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Neni 49 i Kushtetutës përcakton që:

E drejta e punës garantohej.

17. Neni 54 i Kushtetutës përcakton që:

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

18. Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).
19. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kërkesës ka pasur gjykim të drejtë (Shih *Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të 23 qershorit 2010, në rastin KI 40/09, Imer Ibrahim dhe 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, para. 66 dhe 67*).
20. Parashtruesi thjesht konteston nëse Gjykata Supreme e ka zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin e zbatueshëm dhe thjesht nuk pajtohet me gjetjet faktike të vendimit të Gjykatës

Supreme lidhur me statusin e punësimit të kandidatëve të suksesshëm për pozitën e kontestuar. Duket që padia e parashtruesit është e papranueshme.

21. Pas shqyrtimit të procedurave në këto gjykata të rregullta si tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituaniës, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
22. Përveç kësaj, parashtruesi nuk kishte dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (shih *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005*).
23. Prandaj, rezulton që kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe rregullit 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Ivan Čukalović



Prof. dr. Enver Hasani

